



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 49 datë 06.07.2016

Për

**“DELEGIMIN E FUNKSIONIT TË MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE,
NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE FUNERALE “TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 7, nenit 33, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, nenit 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 113, të ligjit nr.44 /2015, datë 09.04.2015 “ Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 3, pika 4 të Ligjit nr.9220, datë 15.04.2004, për « Administrimin e shërbimit të varrimit » (i ndryshuar) ; nenit 44, paragrafi i dytë shkronja « a » të Ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 për « Menaxhimi e sistemit buxhetor » (i ndryshuar) ; nenit 8, të ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për « Buxhetin lokal » (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 58 datë 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë delegimin e funksionit të mirëmbajtjes së varrezave, Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale të Tiranës.
2. Për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, të miratojë subvencionin për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave në vlerën prej 9,500,000 lekë, artikulli (6032099), duke pakësuar fondin rezervë dhe duke shtuar në të njëjtën shumë aparatën e Bashkisë në programin e Shërbimeve Publike Vendore, të detajuar sipas Tabelës nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Pika 3 shkronja “a” e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.21, datë 10.11.2011 “Për riorganizimin e strukturës organizative të disa ndërmarrjeve në varësi të bashkisë së Tiranës”, shfuqizohet.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike si dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale të Tiranës.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI